

NË EMËR TË POPULLIT
P.nr.5493/17

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtarine vetëm gjykues Rrustem Begolli, me sekretaren juridike Sanije Trashupa, në çështjen penale, kundër të pandehurit A.A., për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1584/2017, të dt.29.11.2017, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për dhënien e urdhrit ndëshkimorë PP.II.nr.1584/2017, të dt.29.11.2017, më dt.**17.01.2018**, jashtë seancës, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1584/2017, të dt.29.11.2017 dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri:A.A., i biri i D., i lindur me ..., në P.1, ku edhe jeton në lagjen „V.1, rr.,E.H.”, nr....., me numër personal ..., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

S e p s e:

Me datë 22.02.2017, rreth orës 19:40, në Prishtinë, në lagjen „V.2”, rr.,Rr. H.”, i pandehuri duke drejtuar automjetin e tipit „Iveco Daily” ngjyrë e bardh, me targa ..., nga pakujdesia ka shkelur ligjin mbi trafikun publik, ka rrezikuar trafikun publik dhe ka vënë në rrezik jetën e njerëzve, në atë mënyrë që duke vepruar në kundërshtim me nenin 41.1 dhe neni 53.1 të Ligjit nr.05/L-88 për rregullat e trafikut rrugor, i pandehuri duke qenë i pakujdesshëm në veprimet e veta, duke lëvizur mbrapa me automjet prej shiritit të djathtë në të majtë, në mënyrë të pasigurte dhe pa i kushtuar kujdesin e duhur lëvizjes, ndeshet me automjetin „B” e tipit „Opel Vectra” ngjyrë e gjelbër, me targa të regjistrimit ... të cilën e drejtonte i dëmtuari H.A., me ç’rast pëson lëndime të lehta trupore, me dëmtime të përkohshme për shëndetin.

-me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 41, 43, 46, të KPRK, si dhe neneve 365 e 495, të KPP të Republikës së Kosovës, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

I pandehuri A.A. dënohet në shumë prej **250€ (dyqindpesëdhjetë euro)**, të cilin dënim, është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20 (njëzet)€ të gjobës.

I pandehuri obligohet të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë për ekspertizën e komunikacionit shumën prej **40.88€**dhe ekspertizën mjeko-ligjore në shumë prej **20.00 €**, ndërsa në emër të paushallit gjyqësorë do të paguaj shumën prej **20 (njëzet) €**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari H.A., nga fshati P.2, Komuna e P.3, me numër të telefonit ..., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, me Aktakuzën PP.II.nr.1584/2017, të dt.29.11.2017 ka akuzuar **A.A.**, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe njëherësh, nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrit ndëshkimorë, me arsyetimin së ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se i pandehuri vërtetë e ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtarii vetëm gjykues, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493, të KPP të Republikës së Kosovës, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495, të KPP i RK, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë: kallëzimi penal i Policisë së Kosovës nr.2017-AR-0434,i datës 22.02.2017, ekspertiza e komunikacionit e datës 12.04.2017, akt ekspertimi mjeko-ligjor në bazë të dokumenteve të çështjes i datës 03.04.2017; dhe foto dokumentacioni me shkresat e tjera të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Pas vlerësimit me shumë kujdes të gjitha provave materiale të lartcekura, gjykata vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë nga: ekspertiza e ekspertit të komunikacionit ing. i dip,S.B. e dt.12.04.2017,konstaton se drejtuesi i automjeti „A” i markës „Iveco Daily”, gjatë ngasjes së automjetit nuk ka qenë i kujdesshëm në veprimet e veta duke lëvizur mbrapa me automjeti prej shiritit të djathtë në të majtë në mënyrë të pasigurt dhe pa i kushtuar kujdesin e duhur lëvizjes së automjetit „B”, dhe si pasojë e këtij veprimit të gabuar është shkaktuar edhe aksidenti i komunikacionit rrugor.

Në bazë të mendimit të ekspertit mjeko-ligjor Dr.F.B., të datës 03.04.2017për të dëmtuarin H.A.: dëmtimet e përshkuara në bazë të dokumentacionit mjekësorparaqesinndrydhje të indeve të buta të regjionit të qafës, gishtit të III-të të dorës së majtë, një s të krahut të majtë dhe regjionit i dorës, të shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo i mprehtë), dhe si të tilla kualifikohen në dëmtime të lehta trupore me dëmtim të përkohshëm të shëndetit

Duke u bazuar në këto që u cekën me lartë, gjykata konstaton se i pandehuri A.A., është penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6, lidhur me par.1 të KPRK, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë elementet e kësaj vepre penale.

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 74 të KPK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësorë, është marrë në bazë të nenit 450 par. 1 dhe 2, pika 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Në bazë të nenit 463, par. 1 dhe 2, të KPP-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495, të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.5493/17, i dt.17.01.2018

Sekretarja juridike
Sanije Trashupa

Gjyqtari,

Rrustem Begolli

KËSHILLË JURIDIKE:

I pandehuri ose mbrojtësi i tij, në afat prej tetë(8) ditëve, pas pranimit të këtij aktgjykimi-urdhri ndëshkimorë, mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë.